

VENDIM
Nr.41, datë 15.4.2011

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË
SHOQËRISË “ENERGJI ASHTA” SHPK PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT
PRODHUES HEC “ASHTA” SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2 germa “II”, dhe nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 18 pika 1 germa “d”, dhe 3 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, dhe nenit 8 të Rregullave dhe Procedurave të Certifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve në mbledhjen e tij të datës 15.4.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Energji Ashta” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues hec “Ashta”, si burim i rinovueshëm energjie, dhe konstatoi rregullshmërinë e paraqitjes së aplikimit të shoqërisë “Energji Ashta” sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Energji Ashta” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues hec “Ashta”, si burim i rinovueshëm energjie.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Entela Shehaj